



P Z A P  
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.264/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizm me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Subjekti Politik, Koalicioni Për Familje me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 01.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizm me seli në Prishtinë, Anr.264/2025, e datës 30.01.2025.

II. Subjektit politik Koalicioni për Familje me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënim i më gjobë në lartësi prej 7,600.00€ ( shtatëmijegjashtëqind) euro.

III. Detyrohet Subjekti Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 30.01.2025, PZAP ka pranuar një ankesë nga OJQ Qendra për Barazi dhe Liri (CEL Kosova) dhe Dylberizm me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se me datë 28 janar 2025, ora 18:00, gjatë fushatës zgjedhore të subjektit politik Koalicioni për Familje në qytetin e Ferizajt, ngjarje e cila më pas është postuar në rrjetin social Facebook, janë bërë deklarata të cilat përbajnë gjuhë nxitëse dlje stigmatizuese ndaj komunitetit LGBTI+, duke shkelur standarde ligjore dhe etike të përcaktuara nga Kodi i Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët. Deklaratat janë bërë nga kandidati për deputet i këtij subjekti, z. Eman Rrahmani, dhe përfshijnë elemente që nxisin urrejtje dhe stigmatizim të drejtpërdrejtë ndaj një komuniteti të caktuar.

Deklarata e evidentuar: "Andaj, ne si koalicion, në asnje mënyrë mik do të dorëzohemi përballë presioneve dhe dënimive të cilat po provohen përmes gjitha institucioneve, qoftë atyre shtetërore, qoftë organizatave të cilat shërbehen nga ta dhefinancohen nga ta. Po thonë që nuk bon me ju thanë "turp" atyre që e cenojnë familjen. Turp edhe marre, secilit, organizatëjo-qeveritare qëfinancon në degjenerimin e fmive! Turp edhe marre, secilës qeveri e ministri që këto organizata ifinancojnë për me prisë familjen shqiptare! Turp edhe marre secilës komunë e secilit kiyetar komune që ifinancojnë këto organizata, me eprishëfamiljen! Kurrë nuk do mund të na ndalni! Kurrë mik do të ndalemi! Në këtë deklaratë, frazat si "degjenerimi i fmive" dhe "prishja e familjes shqiptare" stigmatizojnë organizatat që mbrojnë të drejtat e komunitetit LGBTI+ si dhe vet komunitetin LGBTI+, duke i paraqitur ato si kërcënimi për shoqërinë dhe familjen tradicionale. Përveq kësaj me 29 Janar 2025, kandidati tjetër i Koalicionit për Familjen, z. Asdren Bytyqi, ka shpërndarë një postim nga një mbështetës i koalicionit në rjetin social Facebook, i cili përmban deklaratën nënçinuese dhe stigmatizuese ndaj komunitetit LGBTI+ dhe praktikës së surrogacisë. Teksti i postimit thotë: "Garant edhe dreçit i kane dhane nasihat! Kshtiu, kta dy hakaretat e kane perdore surrogacine si mjet per mi ble ktoo dy zemra t'vogla, drita t 'pafajshme, shpirta t'vogel Pra e kane pagu me qera (for-rent) mitren e ni gruje nevojlike per pak paire qe ktyne me tua mundesu m 'u "bo " prinder: Praktikisht kiafmijacion t 'destinimi kurre mos me pase nane ndersa kilimi o se kane m 'u rrite prej klyne t'smutve. E di qe po terrqethni ama ligjerisht o komplet e lejuinie! — Pérndryshe e permblledhe totalishtpa i s/itu as pike as presje se çka përmban kalimi i kodit civil. Ma bre se shqiptarë jem; dy gisht ftyre i kem bre. Herën e kaluem ka pshtu për pak ndërsa tash siguresë t 'vetme qe s'kalon e kemi Koalicioni për Familjen. Ky postim përimban përbajtje nxitëse, ofenduese dhe diskriminuese ndaj personave LGBTI+, duke ju referuar si të sëmurë dhe fëmijëve të lindur pëimes sunogacisë, duke përhapur narrativë denigruese dhe të rrezikshme në diskursin publik. Parashtruesi i ankeses ka bashkangjitur ankesës linkun.

PZAP me datë 30.01.2025 iu është drejtuar me kërkesë për përgjigje subjektit politik Koalicionit për Familje, mirëpo ky subjekt politik nuk është përgjigjur në afatin e paraparë deri më datë 31.01.2025, e as më vonë.

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, vëren se:

### Ankesa është e bazuar.

Paneli, pas shikimit të shkresave të ofruara si provë materiale në ankesë, të cilat janë bërë nga Koalicioni për Familjen, respektivisht nga kandidati për deputet Eman Rrahmani i cili gjatë fushatës ka deklaruar duke përdorur fjalët "Andaj, ne si koalicion, në asnje mënyrë mik do të dorëzohemi përballë presioneve dhe dënimive të cilat po provohen përmes gjitha institucioneve, qoftë atyre shtetërore, qoftë organizatave të cilat shërbehen nga ta dhe financohen nga ta. Po thonë që nuk bon me ju thanë 'turp' atyre që e cenojnë familjen. Turp edhe marre, secilit, organizatë jo-qeveritare që financojnë në degjenerimin e fmive! Turp edhe

*marre, secilës qeveri e ministri që këto organizata i financon për me prish familjen shqiptare.....” si dhe kandidati tjetër i Koalicionit për Familjen Asdren Bytyqi i cili ka shpërndarë një postim nga një mbështetës i koalicionit në rrjetin social Facebook, ku teksti i postimit thotë: “Garant edhe dreqit i kane dhanë nasihat! Kshtu, kta dy hakaretat e kane përdore surrogacine si mjet për mi ble këto dy zemra t ‘vogla, drita t ‘pafajshme, shpirta t ‘vogël Pra e kane pagu me qera (for-rent) mitrën e nië gruje nevojlike për pak pare që këtyre me tua mundësua m ‘u “bo “prindër.....” gjen se të njëjtat janë të bazuara, sepse përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, pika I.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet, “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalojen nga bërja e ndonjërs si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografji, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”. andaj për Panelin një veprim i tillë i subjektit politik në fjalë është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura.*

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të janë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj, Paneli gjeti se gjuha e përdorur nga subjektit politik Koalicioni për Familjen, përkatesisht, nga kandidati i këtij subjekti Eman Rahmani, ndaj LGBTI+, në fushatë zgjedhore dhe rrjetin sociale Facebook, dhe postimi i shpërndarë nga kandidati i këtij koalicioni, Asdren Bytyqi, është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatesisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1, pika I.11, të LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike. Në këtë rast është marrë për bazë konteksti dhe qëllimi për të cilin është përdorur gjuha ndaj një komuniteti, faktin që deklaratat janë publikuar në rrjetin social Facebook, prandaj sipas Panelit, përdorimi i gjuhës së tillë ka për qëllim ofendimin, denigrimin dhe njëherit shihen si shprehje me ngjyrimë përcmuese ose nënvlerësuese. Rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse. Përdorimi i kësaj gjuhe nga kandidatet për deputet sipas Panelit është shkelur etika zgjedhore dhe standardet e sjelljes në fushatë zgjedhore. Sjellja e tillë minon procesin demokratik dhe promovimin e zgjedhjeve të lira e të drejta. PZAP, me rastin e shqiptimit të gjobës ka marrë për bazë kontekstin se deklarata është bërë në kohën e fushatës zgjedhore dhe se fjalitë e përdora i referohen grupeve të caktuara dhe si të tillë përbajnjë elemente të nxitjes së urrejtjes, diskriminimi dhe cenim të drejtave të grupeve që u është referuar.

Fushatat zgjedhore duhet të zhvillohen në një ambient të ndershëm dhe të drejtë, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e të gjithë qytetarëve dhe grupeve shoqërore. Shprehjet që përdorin fjalë si “turp” dhe “marre” për të sulmuar individë, grupe apo organizata të caktuara mund të krijojnë një atmosferë të pasigurt dhe të ndarë, duke shkelur kështu parimet e një fushatë pozitive dhe të respektueshme.

Paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rr Ethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e rregullave zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje përkatesisht faktin se i njëjtë subjekt edhe disa raste në këtë fushatë zgjedhore është dënuar për përdorim të gjuhës së urrejtjes, por përkundër kësaj ka vazhduar me përsëritjen e shkeljes. Në lartësinë e gjobës paneli ka marrë për bazë faktin se subjekti politik në fjalë nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes buxhetit të Republikës së Kosovës.

Prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, ankesën e parashtuar e konsideron të bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 pika 1.11),, nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A.nr.264/2025, datë 01.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.